

**STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
BISCHA ELEKTRO TECHNIK SHPK**

NENI 1

KRIJIMI DHE EMRI

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **BISCHA ELEKTRO TECHNIK shpk.** (ne vijim e quajtur "Shoqeria") themelohet ne zbatim te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

Shoqeria fiton personalitet juridik ne momentin e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar shqiptar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne Tirane, Shqiperi.

NENI 2

SELIA

Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Njesia Bashkiake Nr 5, Rruga Ismail Qemali Nr. 29/1, Ap 3, Tirane, Shqiperi.

Shoqeria mund te hape dege, zyra perfaqesie dhe te krijojë filiale ne qytete te ndryshme te Republikes se Shqiperise dhe/ose jashte saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 3

OBJEKTI

Shoqeria do te kete per objekt te aktivitetit kryerjen e çdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrjen ne çdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar, siç mund te ndryshohet here pas here. Aktiviteti i Shoqerise do te perfshije, por nuk do te kufizohet me punime elektrike, shtrirje kabulli, prerje muresh, montime te ndryshme dhe te ngjashme me keto.

NENI 4

KOHEZGJATJA

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar.

NENI 5

KAPITALI

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100 Leke (njeqind Leke). Kapitali eshte i ndare ne 1 kuote me vlere nominale 100 Leke.

Kapitali ne para eshte nenshkruar dhe derdhur nga Ortaku i vetem zoterues i 100% te kapitalit te Shoqerise.

Pergjegjesia e Ortakut te vetem per detyrimet e Shoqerise shtrihet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise.



NENI 6

ORTAKU I VETEM

Ortak i Vetem i Shoqerise eshte Z. Arbis Prifti shtetas shqiptari lindur me 29.02.1988, ne Fier, mbajtes i pasaportes numer personal I80229069F.

Ortaku i Vetem, mund te marre çdo vendim, pa asnje kufizim sipas legjislacionit shqiptar. Te gjitha vendimet e marra ne kete menyre do te regjistrohen ne Regjistrin e Vendimeve te Ortakut te Vetem, te dhenat e te cilit nuk do te mund te ndryshohen apo fshihen.

Çdo vendim i cili nuk regjistrohet ne Regjistrin e Vendimeve te Ortakut te Vetem eshte i pavlefshem. Kjo nuk do te ndikojë ne pergjegjesine e Shoqerise ndaj paleve te treta pervec rasteve kur Shoqeria do te vertetoje se pala e treta kishte dijeni per parregullsine apo ne baze te rrethanave nuk mund te mos kishte patur dijeni.

Çdo vendim i Ortakut te Vetem mund te merret jashte territorit te Republikes se Shqiperise dhe nje evidence me shkrim per çdo vendim te marre jashte do t'i dergohet administratorit, i cili duhet ta regjistroje ate ne Regjistrin e Vendimeve te Ortakut te Vetem.

NENI 7

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Pasuria, veprimtaria dhe aktiviteti i Shoqerise do te administrohet nga nje administrator.

Shkarkimi apo zevendesimi i Administratorit do te kryhet me vendim te Ortakut te Vetem dhe ky shkarkim apo zevendesim nuk do te konsiderohet si ndryshim i ketij Statuti dhe vendimi perkates i Ortakut te Vetem nuk eshte i nevojshem te reflektohet ne Statut.

Administratori i shoqerise eshte Z. Arbis Prifti, shtetas shqiptari lindur me 29.02.1988, ne Fier, mbajtes i pasaportes numer personal I80229069F.

Administratori do te ushtroje kompetencat e tij perkatese deri ne me te parin nga rastet e meposhtme:

- largimi i tij; ose
- verifikimi i ngjarjeve te percaktuara ne kete Statut te Shoqerise; ose
- perfundimi i afatit 5 vjeçar nga data e regjistrimit te Shoqerise me Regjistrin Tregtar, nese mandati nuk eshte rinovuar.

Administratori i Shoqerise mund t'i transferoje çdo personi apo grupi personash te gjithe apo nje pjese te kompetencave te tij sipas ketij Statuti dhe me kushtet qe ai konsideron si te arsyeshme dhe ne çdo kohe mund te anulloje kete transferim kompetencash.

NENI 8

EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

Eksperti(et) kontabel i (te) autorizuar do te emerohet(n) me vendim te Ortakut te Vetem ne çdo rast kur nje gje e tille kerkohet nga ligji shqiptar ose kur Ortaku i Vetem e konsideron te nevojshme.